



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 60/1 Prot

Elbasan, më 29.1.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË PEQIN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.72, datë 28.12.2023 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Peqinit", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Majlinda PERRIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 72.Prot.

Peqin, më 29/12/2023

VENDIM

Nr. 72 Date 28.12.2023

“PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË E PEQINIT”

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, date 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, legjislacionit të aplikueshëm ne fuqi, akteve nënligjore të miratura në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituar, bazuar në relacionin e hartuar nga grupi i punës për përgatitjen e paketës fiskale për vitin 2024 e në vijim, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Lejeve dhe Liçensave, Këshilli i Bashkisë Peqin në mbledhjen e datës 28.12.2023;

VENDOSI :

1. Të miratojë sistemin e taksave dhe tarifave vendore në territorin administrativ të Bashkisë Peqin për vitin 2024 e në vijim, si më poshtë:

**KREU I
TAKSAT VENDORE**

Llojet, baza tatimore, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese dhe agjenti tatimor.

Në taksat vendore përfshihen;

1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin
3. Taksa e fjetjes në hotel
4. Taksa e ndikimit në infrastrukture
5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme
6. Taksa e tabelës



7. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura
8. Taksa të përkohshme

I. Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël

Sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar) dhe legjislacionit tatimor në fuqi, në Republikën e Shqipërisë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

II. Taksa mbi Pasurine e Paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme në territorin e Republikës së Shqipërisë, nën juridiksionin administrativ të Bashkisë Peqin, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit mbi pasurinë e paluajtshme. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumenta pronësie.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

Sipërfaqja në pronësi e taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që vërtetojnë pronësinë të leshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Peqin.

Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesi, Drejtoria e të Ardhurave Vendore e Bashkisë Peqin, për vërtëtim pronësie njeh:

- a) Vendimet e Komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronës.
- b) Vendimet e privatizimit.
- c) Dokumentat e tjera të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtëtimin të pronësisë, Këshilli Bashkiak Peqin vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e Komisionit të Verifikimit të Pasurive të Paluajtshme, të ngritur me vendim nga ana e Këshillit Bashkiak Peqin, në rast mungese të dokumentacionit ligjor, pranë Bashkisë Peqin”, në zbatim të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 24.

Në rastin e sipërfaqes së ndërtesës të dhenë në përdorim, nëse në marrëveshjen midis pronarit dhe përdoruesit është përcaktuar detyrimi i këtij të fundit për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme, madhësia e sipërfaqes së pasurisë së taksueshme do të përcaktohet në bazë të dokumentit (kontratë/marrëveshje) të lidhur mes paleve.

Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose komune, pavarësisht nga vendbanimi i pronarit, secila njesi vendore e trajton pjesen e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë në vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi tokën bujqësore



Taksa mbi truallin

1. Taksa mbi Ndërtesën

Taksa mbi ndërtesat

Metodologjia për llogaritjen e taksës së ndërtesës;

Perkufizime:

“Çmim vlerësues”, njesia matëse e vlerës për meter katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar.

“Ndërtesë”, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

“Ndërtesë e papërfunduar”, objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

“Njësi pronësore”, ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjrisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”. Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.

“Ndarje e njësisë pronësore për banim”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.

“Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.

“Përdorues”, individi, personi fizik ose juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.

“Taksapagues”, çdo individ, person fizik ose person juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë” e kanë sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zoteron apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

“Vlera e pasurisë”, Vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për meter katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.

“Veprimtari ekonomike”, çdo veprimtari kryer nga prodhuesit, tregtarët personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe.

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.



Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme - ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit.

1.2) Çmimi mesatar referues

Çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Peqin është **39.000 leke/m²**.

Çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim janë si më poshtë vijon:

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është **1.5 (nje pikë pesë)** herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është **70 (shtatedhjetë)** për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to, porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë është **30%** e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit në qytet.

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuar për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si fabrika, magazine, depo, silos, magazinë frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshijë ato të njësive të tregtimit dhe shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është **50%** e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse.

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetës, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është **30 (tridhjetë)** për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuar për banim në njësitë administrative jashtë qytetit, të cilat iu bashkuan njësive të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, reduktohet deri në **35 (tridhjetë e pesë)** për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar, çmimi për metër katror është **70 (shtatedhjetë)** për qind e çmimit, vetëm në rastin e shitjes së parë.

1.3) Shkalla e taksës mbi ndërtesat

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) **0.05 %** për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) **0.2 %** për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) **30 %** e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.



Tabela 1

Kategoritë minimale të ndërtësave	Çmimi Miratuar (Leke/m ²)	Shkalla e Taksës (%)	Vlera (Leke/m ² vit)
I.2.1-Ndërtesa banimi			
a-ndërtesa për banim (Shtëpi/Apartamente)	39.000	0.05	19.5
b-Parkim të mbuluar dhe bodrume (70% e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit)	27.300	0.2	54.6
c-Për aktivitet ekonomik shërbim dhe komerciale (1.5% i çmimit të ndërtesave)	58.500	0.2	117
ç-Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngashme me to, porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë është 30% e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit në qytet.	11.700	0.2	23.4
d- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuar për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si fabrika, magazinë, depo, silos, magazinë frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshirë ato të njësive të tregtimit dhe shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50% e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zones përkatëse.	19.500	0.2	39
dh-Për aktivitet bujqësor dhe blektoral (30% e çmimit të ndërtesave)	11.700	0.2	23.4
e-Për parkim të hapur (30% e çmimit të ndërtesave)	11.700	0.2	23.4

Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuar për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambiente të Hipotekuara si:

Apartamente banimi do të nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim”.


Njësi biznesi do të nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret , shfrytëzohet për veprimtari ekonomike”.

Bodrum/Parking i mbuluar do të nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret për parkim të mbuluar dhe bodrume”.

Për sa i përket kategorisë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe si më poshtë vijojnë:

a)100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;

b)70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr.7652, date 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar.



Për sa i përket kategorisë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet e ndërtesës/njesisë pronësore, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.

1.4) Agjenti Tatimor

Të caktojë si agjent tatimor për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për qëllime banimi për kategorinë taksapaguese familjare **Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Licensave dhe inspektorët përkatës të kësaj drejtorie.**

1.5) Afatet e pagesës

1. Detyrimi vjetor për kategorinë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim do të paguhet brenda datës 30.10 të vitit vijues.

2. Detyrimi vjetor për kategorinë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike do të **paguhet brenda datës 30.06. të vitit vijues.**

Detyrimi vjetor për taksën mbi ndërtesën do të paguhet pranë sporteleve të bashkisë Peqin dhe njësive administrative dhe/ose pranë sporteleve të bankave të nivelit të dytë.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguaj shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë **0,06 per qind të shumës së detyrimit të papaguar** për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagese të gjithë taksapaguesit familjarë.

3. Përfshihen nga taksa mbi ndërtesat:

- pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimpruese;
- pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqerive publike shtetërore;
- ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarresi me qira të paliberalizuara;
- banesat sociale në pronësi të bashkive;
- pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrveshjeve me bashkitë përdoren nga keto të fundit si banesa sociale;
- ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizimit dhe që janë mbajtes të një marke tregëtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
- ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
- ndërtesat e banimit të kryefamiljareve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgimisë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimpruese";

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për kategorinë subjekte familjar dhe biznesin është Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Peqin.

2. Taksa mbi tokën bujqësore

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi dhe përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore pranë Bashkisë Peqin. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumezim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Tabela nr.2

Nr.	Klasifikim sipas kategorisë së tokës (zona e dyte)	Vlera e taksës në lekë/hektar/vit
1	Kategoria e I	4.200
2	Kategoria e II	3.500
3	Kategoria e III	2.800
4	Kategoria e IV	2.300
5	Kategoria e V	1.900
6	Kategoria e VI	1.600
7	Kategoria e VII-X	1.400

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Peqin në bashkëpunim me “Njësitë Administrative”.

3. Taksa mbi truallin

Truall është një sipërfaqe toke, jobujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në m², në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë Bashkisë Peqin.

Tabela nr.3

Nr.	Klasifikim sipas kategorisë së truallit	Vlera e taksës në lekë/ m ² /vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/ m ² /vit për qëllime biznesi
1	Kategoria II	0.42	18

Taksa mbi truallin për qëllime banimi nga individët detyrimi paguhet në 12 keste të barabarta, për çdo muaj. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likujdimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit”.

Agjenti tatimor për Taksën mbi truallin për qëllime banimi nga individët është Ujesjellës - Kanalizime sh.a. Peqin.

Taksa mbi truallin për qëllime biznesi struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Peqin në bashkëpunim me “Njësitë Administrative”.



III. Taksa e Fjetjes në Hotel

Me "hotel" do të kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin njerin ose disa nga emertimet se bashku: hotel, motel, stabiliment turistik, shtëpi pritje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këte qëllim, pavarësisht emertimit që mban.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel, për person.

Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga Bashkia Peqin, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili, mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë Peqin dhe derdhet në favor të Bashkisë Peqin brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Në fakturen e hotelit shenohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Niveli i taksës që aplikohet është për natë qëndrimi janë si vijon;

Tabela nr.4

Nr.	Kategoritë të taksës së fjetjes në hotel	Leke për natë fjetje
1	Zona 3	
1.a	Hotelet 4-5 yje	105
1.b	Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	35

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Peqin në bashkëpunim me "Njësiti Administrative".

IV. Taksa e Ndikimit në Infrastruktura

Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Niveli i taksës sipas kategorive dhe nën kategorive për klasifikimin e investimeve sipas Lejeve në tabelen me poshtë është si me poshtë:

Tabela nr.5

Kategorite dhe nënkategorite në ndërtimet e reja	Ndikimet në %
1. Leje zhvillimore ndërtimi me funksione banimi, administrative, shërbimi dhe tregtimi	2 %
2. Leje zhvillimore ndërtimi për qëllime me interes publik, kopshte, çerdhe, shkolla, rrugë komunitare (private dhe shtetërore)	2 %
3. Leje zhvillimore infrastrukture, ujesjellës, kanalizime	2 %
4. Leje zhvillimore komplekse për ndërtimet e rrugëve kombëtare, porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, investime në energji	0.1%
5. Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi	0.5%
6. Leje zhvillimore e veçantë	3%
7. Taksa e ndikimit në infrastrukturë për shoqëritë e ndërtimit për qëllime banimi apo shërbimi	6%



Për zenie hapësira publike, në ndërtim për makineri ndërtimi, materiale inerte dhe rrethime të përkoheshme për ngritjen e kantierit të ndërtimit.

Tabela nr. 5/1

1. Çdo kantier ndërtimi për objekte mbi 4 kate	50 000 lekë /vit
2. Çdo objekt ndërtimi për objekte \leq 4 kate	20 000 lekë /vit
3. Për ndryshime destinacioni	5 000 lekë /vit
4. Rikonstruksione struktura të ndryshme	5 000 lekë /vit

Kjo takse paguhet para marrjes së formularit të lejes së ndërtimit, në masat e percaktuara më sipër.

Për investimet sipas pikës 4 të tabelës 4, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 0,1%, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të strukturës së demtuar.

Agjenti tatimor;

Struktura e ngarkuar për llogaritjen, leshimin e autorizimit dhe ndjekjen e pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Peqin.

IV. Taksa mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluajtshme

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e se ciles transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës.

Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzimi i nivelit të taksës me bazën e tij.

Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 përqind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzimi i nivelit të taksës me bazën e tij.

1. Niveli i taksës sipas kategorive, është si vijon:

Tabela nr.6

Nr.	Kategorite	Njësia	Niveli taksës
1	Ndërtesa banimi	lekë/m ²	100
2	Ndërtesa për tregti dhe shërbime	lekë/m ²	300
3	Ndërtesa të tjera	lekë/m ²	200

Perjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";
- Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtëpërdrejtë janë:
 - institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
 - bashkësitë fetare ose organizatat jofitimpruese, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në keto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak



për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

Agjenti për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, është Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila perfiton 3 % të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të Bashkisë Peqin.

V. Taksa e Tabeles

Taksa e tabelës aplikohet për subjektet tregtare që ushtrojnë veprimtari nën juridiksionin administrativ të Bashkisë Peqin dhe vendosin emrin/emertimin ose çdo të dhënë tjetër, në njesinë ku zhvillojnë aktivitetet.

Vendosja e tabelës është e detyrueshme për të gjithë subjektet me përjashtim të ambulanteve, tregtareve që ushtrojnë aktivitet në tregjet e miratuara, mjeteve të transportit rrugor.

Kategoritë dhe niveli i taksës jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.7

I.	Takse tabelë për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të treta (ku shenohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)		
a	deri në 2 m ²	lekë/m ² /vit	0
b	mbi 2 m ² deri në 10 m ²		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	7.000
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	11.500
	-elektronike	lekë/m ² /vit	15.000
c	mbi 10 m ² deri 20 m ²		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	5.950
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	9.775
	-elektronike	lekë/m ² /vit	12.750
ç	mbi 20 m ² deri 40 m ²		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	3.850
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	6.325
	-elektronike	lekë/m ² /vit	8.250
d	mbi 40 m ²		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	2.800
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	4.600
	-elektronike	lekë/m ² /vit	
II.	Tabele për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	Tabela identifikuese	lekë/m ² /vit	120
III.	Tabela për qëllime reklamimi e lëvizëshme e palëvizëshme deri në tavanin maksimal 35 m ²		
	e thjeshtë (me/pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	13.500
	Elektronike	lekë/m ² /vit	27.000
IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderol, etj.		
	Të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m ² /vit	1.000



Afati i shlyerjes se detyrimit për kategorinë 1, 2 dhe 3 është data 20 Korrik të vitit fiskal. Struktura kompetente për dhenien e Lejeve për vendosjen të tabelave për kategorinë 2, 3 dhe 4 është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.

Sqarime;

- Për kategorinë 1 **“Tabele për qëllime identifikimi”**, vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet tregtare.
- Për kategorinë 2 dhe 3 **“Tabele për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike”**, për vendosjen e saj çdo subjekt duhet të kryej keto procedura :
 1. Paraqitja e kërkesës me shkrim pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
 2. Paraqitja e planvendosjes.
 3. Marrja e miratimit nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit
 4. Pagesa e lejes për vendosjen e reklames
 5. Lidhja e kontratës dhe pagesa e taksës për qëllime reklamimi
- Për kategorinë 4 **“Tabele në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura (Panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj)”**, detyrimi për taksën e tabelës llogaritet sipas diteve të percaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Peqin. Kjo leje të mos jepet pa aprovimin dypalësh të Drejtorisë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës është Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Peqin në bashkëpunim me “Njësitë Administrative”.

VI. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

Drejtorite Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këto taksa dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogaritë të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njesive të qeverisjes vendore. Drejtoria Rajonale e Sherbimeve të Transportit Rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njesive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin (komune, bashki) të taksapaguesit që zoteron mjetin e transportit.

Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arketuar nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtorite rajonale të DRSHTRR-se, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pese) % të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të fatures për arketim, 18 (tetëmbëdhjetë) % të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njesia e qeverisjes vendore dhe 82 (tetëdhjetë e dy) % të të ardhurave, DPSHTRR-ja e derdh për llogaritë të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të medhenj).

Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-se me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

KREU II TARIFAT VENDORE

Tarifat vendore të aplikueshme në Bashkinë Peqin janë:

1. Tarifa për Zenien e Hapësirave Publike për qëllime biznesi
2. Tarifa gjelberimit
3. Tarifa e pastrimit



4. Tarifa ndriçimit
5. Tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit për biznesin e vogël
6. Tarifa e parkimit të automjeteve
7. Tarifa e shërbimeve administrative të Bashkisë Peqin
8. Tarifa për transport publik
9. Tarifa e autorizimeve për tregtim karburanti
10. Tarifa të tjera vendore
11. Tarifa të shërbimit veterinar
12. Tarifa e urbanistikës
13. Tarifa e ndotjes
14. Tarifë për kalimin e linjave tokësore dhe ajrore
15. Tarifa të institucioneve të varesise
16. Tarifa të perkohshme për vaditje
17. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregtar pa license, autorizim apo lejen perkatese.

1. Tarifa për Zenien e Hapesirave Publike për qellime biznesi

Baza e tarifës është sipërfaqja në meter katror për sipërfaqe publike të zene nga subjektet për qëllime biznesi.

